



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Testim dhe Vlerësim i gjuhës B

Ngarkesa mësimore: 5 kredite; 50 orë mësim; 30 leksione / 20 seminare

Viti / Semestri: Viti i parë , Semestri i dytë

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Mësuesi

Kodi i etikës: Kodi i Etikës së Universitetit të Tiranës (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të pajisë studentët me njohuri themelore dhe të avancuara mbi matjen dhe vlerësimin në arsim.

Të orientojë studentët drejt përballimit të sfidave aktuale dhe të njohin perspektivat e vlerësimit në procesin mësimor.

Të zhvillojë qëndrime profesionale dhe reflektuese në lidhje me procesin e vlerësimit dhe vetëvlerësimit në kontekstin shkollor.

Objektivat specifike lëndore:

1.Të aftësojë studentët të përzgjedhin dhe përdorin instrumente të përshtatshme të matjes dhe vlerësimit sipas objektivave mësimorë.

2.Të zhvillojë kompetenca për hartimin, administrimin dhe analizimin e testeve dhe mjeteve të tjera vlerësuese.

3.Të nxisë studentët të interpretojnë dhe raportojnë rezultatet e nxënësve në mënyrë profesionale, duke përdorur mjetet përkatëse të mbikëqyrjes dhe të dokumentimit.